Kronikë

Lezhë/ Arrestohen 3 të rinj dhe vihet nën hetim i mituri! Në makinë iu gjet kanabis e thikë, njëri kishte 60 plumba në shtëpi (EMRAT)

Gjatë kontrollit në automjet u gjet dhe u sekuestrua lëndë e dyshuar narkotike kokainë dhe kanabis, si dhe një thikë.

Redaksia
21 Tetor, 16:14 | **Përditësimi: 21 Tetor, 16:30**

Share

LEZHË – Tre të rinj janë arrestuar sot dhe një i mitur është vënë nën hetim, pasi udhëtonin me me automjet me lëndë narkotike me vete dhe armë të ftohtë, dhe tentuan t'i shmangeshin kontrollit të policisë.

Në komunikatën zyrtare të bluve sqarohet se Marsel Margjoni, Henri Ismaili dhe Pietro Gega, po lëviznin me një automjet tip "Benz" në aksin rrugor "Shëngjin-Kune", kur i ndaluan policisë pas disa minutave ndjekje.

Gjatë kontrollit në automjet u gjet dhe u sekuestrua lëndë e dyshuar narkotike kokainë dhe kanabis, si dhe një thikë.

LEXO EDHE:
Protesta e minatorëve në Spaç, dialogu me kompaninë i ndërmjetësuar nga ministria e Ekonomisë nuk ka rezultat

Policia bën me dije se gjatë kontrollit të banesës së Pietro Gegës, një 26-vjeçar me precedent penal në fushën e narkotikëve, u gjetën dhe u sekuestruan 60 fishekë për armë zjarri pistoletë.

> *"U arrestuan në flagrancë shtetasit M. M., 19 vjeç, H. I., 18 vjeç, dhe P. G., 26 vjeç, të tre banues në Shëngjin. U procedua penalisht 17-vjeçari, i cili drejtonte automjetin pa leje drejtimi në momentin e ndalimit nga Policia",- njofton policia.*

Vijojnë hetimet për dokumentimin e plotë të veprimtarive kriminale të këtyre shtetasve.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme.

K.M/Shqiptarja.com

TAG: Lezhë kanabis Marsel Margjoni Pietro Gega Henri Ismaili Shengjin

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 20 Tetor, 09:21

Në dhjetor i mbaron mandati si drejtues i SPAK, si e vlerësoni punën e Dumanit?

Pozitive Negative Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Fier/ U kap flagrancë me doza kanabisi gati për shitje, pranga 29-vjeçarit (EMRI)
21 Tetor, 12:41

Mirditë/ Rrëshqiti në lumin Fan i Vogël, ndërron jetë 49-vjeçari
21 Tetor, 11:17

Shpërndante kanabis në doza, arrestohet 19-vjeçari në Durrës (VIDEO)
21 Tetor, 09:58

Trafik kanabisi nga Tajlanda në Shqipëri, kinezët e kishin ndarë lëndën narkotike në 120 pako të paketuar me qese frutash ekzotike (VIDEO)
21 Tetor, 09:31

Tentuan të fusnin 61 kg kanabis në Shqipëri, arrestohen dy kinezë në Rinas! Droga me THC të lartë u nis nga Tajlanda, ishte ndarë në 4 valixhe (VIDEO)
Sokol Dema
21 Tetor, 08:39

Degradimi i urave/ Pas Milotit shkon drejt shembjes dhe ura e Rubikut! Bashkia kërkon ndërhyrje të shpejtë nga ARRSH
Elvis Hila
20 Tetor, 17:11

Lezhë/ I akuzuar për marrëdhënie intime me të miturën, Gjykata dënon me 12 vite burg 38-vjeçarin
Elvis Hila
20 Tetor, 11:40

Minatorët e Spaçit prej 12 ditësh në protestë, kërkojnë njohjen zyrtare të sindikatës dhe nënshkrimin e kontratës kolektive të punës (VIDEO)
Elvis Hila
20 Tetor, 09:11

Personazh/ Vera Loshi rrëfen betejën me kancerin e gjirit: Kisha forcë të madhe dhe po ia dal! Mesazh grave: Mos kini frikë
Elvis Hila
19 Tetor, 18:38

Shkrimtari shqiptaro-amerikani Zef Përgega promovon 4 botime në Lezhë: Më shumë vëmendje ndaj krijuesve shqiptarë në diasporë
Elvis Hila
19 Tetor, 16:04

Policia iu gjeti kanabis dhe armë në fermën e tyre, arrestohen tre shqiptarët në Greqi
19 Tetor, 14:24

Po transportonin 10 kg hashash për shitje, arrestohen 2 persona në Fushë-Krujë! Sekuestrohet dhe armë zjarri pa leje (EMRAT)
19 Tetor, 11:17

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje